




Lëvizja Botërore për
Fëmijët e Amerikës Latine
dhe Karaibeve



BOTA QË DËSHIROJMË
NJË E ARDHME PËR TË GJITHË



BOTA QË DËSHIROJMË

NJË E ARDHME PËR TË GJITHË





Botim i Lëvizjes Botërore për Fëmijët e Amerikës Latine dhe Karaibeve – MMI-LAC

Tetor 2014

Grupi i Punës Post-2015:

Álvaro Sepúlveda – Marist Foundation International Solidarity, FMSI

Carmen Alvarez dhe Juan Carlos Morales – Viva Network

Jorge Freyre – Save the Children/REDLAMYC

Katia Dantas dhe Pilar Ramirez – Qendra Ndërkombëtare për Fëmijët e Humbur dhe të Shfrytëzuar, ICMEC

Patricia Horna dhe Amanda Rives – World Vision International

Virginia Murillo – Defence for Children International, DNI

Koordinimi i projektit:

Inés Invernizzi – Zyra Ndërkombëtare e SOS Fshatrat e Fëmijëve

Patricia Toquica – Zyra Ndërkombëtare e SOS Fshatrat e Fëmijëve

Autore:

Dora Bardales

Paola Arenas

Përktheu: Olta Çakçiri

Dizajni Grafik: Dora Bardales

Ilustrimet: Carlos Campos

Koordinimi i Botimit dhe Prezantimi:

Zyra Ndërkombëtare e SOS Fshatrat e Fëmijëve

Save the Children

www.movimientoporlainfancia.org

PREZANTIM

I dashur mik,

Dëshirojmë të bashkëndajmë me ty një udhëzues i cili prezanton qëllimet dhe synimet që Shtetet kanë identifikuar – me mbështetjen e shumë personave dhe organizatave në mbarë botën – si fushat prioritare në të cilat duhet punuar për ndërtimin e një bote më të mirë për të gjithë gjatë 15 viteve të ardhshme.

Në muajt në vijim, sektorë dhe qeveri të ndryshme do të diskutojnë për këto qëllime në nivel botëror. Qeveritë, bizneset, organizatat, individët, sikurse dhe fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë, do të kenë të gjithë diçka të rëndësishme për të thënë lidhur me këto qëllime dhe lidhur me punën për arritjen e tyre. **PËR KËTË ARSYE TË FTOJMË TË MARRËSH PJESE NË KËTË PROCES!**

Qëllimi i këtij dokumenti është tju informojë. Është shumë e rëndësishme që ju të dini çfarë mendojnë Shtetet e mbarë botës se cilat janë çështjet prioritare për t'u trajtuar në mënyrë që të përparohet drejt një bote më të mirë për të gjithë.

Është shumë e rëndësishme që të gjithë ne të kontribuojmë duke dhënë mendimin tonë dhe të marrim pjesë në hartimin e këtyre qëllimeve.

Ky dokument do të shërbejë si një mjet vlerësimi për fëmijët dhe adoleshentët si ti, nga vende të ndryshme të botës, në mënyrë që ne të dimë çfarë mendoni ju për këto qëllime, çfarë është e rëndësishme për ju, ç'hapa duhet të ndërmerren për të përmirësuar jetën për të gjithë dhe si mund të ndihmojmë ne për arritjen e këtyre qëllimeve.

Shpresojmë që ky udhëzues t'ju pëlqejë dhe ju falënderojmë për pjesëmarrjen në këtë proces historik!

Lëvizja Botërore për Fëmijët
e Amerikës Latine dhe Karaibeve



ÇFARË DUHET TË DINI PËRPARA SE TË FILLOJMË:



Organizata e Kombeve të Bashkuara

(OKB): Krijuar në vitin 1945, OKB është organizata ndërkombëtare më e madhe ekzistuese, anëtarë të së cilës janë thuajse të gjitha shtetet e botës. Ajo ka detyrën të ruajë paqen dhe sigurinë në botë, të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve që na prekin ne të gjithëve, të promovojë respektin për të drejtat njerëzore të çdo individi (përfshirë fëmijët dhe adoleshentët*) dhe t'u ofrojë të gjitha vendeve mbështetje për të punuar së bashku për këtë qëllim.

Samiti i Mijëvjeçarit: Në vitin 2000, përfaqësues nga atëherë 189 vendet anëtare të OKB-së u mbledhën së bashku për të adoptuar Deklaratën e Mijëvjeçarit. Kjo Deklaratë krijoi një aleancë botërore për luftën kundër varfërisë. Në këtë takim, u hartuan objektivat që ne tani i njohim si Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit.

Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM):** OZHM janë tetë objektiva që Shtetet krijuan për të udhëhequr përpjekjet e përbashkëta të organizatave ndërkombëtare dhe vetë Shteteve në luftën kundër varfërisë dhe urisë

në botë, ndaljen e sëmundjeve si HIV/AIDS, promovimin e barazisë gjinore dhe reduktimin e përqindjeve të braktisjes së shkollës, mes të tjerash.

Këto objektiva pritej të arriheshin brenda vitit 2015. Herë pas here, Shtetet i dorëzojnë OKB-së raporte mbi punën e tyre për arritjen e OZHM. OKB shqyrton përparimin e Shteteve dhe vlerëson sa të suksesshëm kanë qenë ata në arritjen e tyre.

Agjenda Post-2015: Çfarë ndodh kur OZHM janë përmbytur dhe ç'vjen pas vitit 2015? Edhe pse janë bërë shumë përparime, në mbarë botën, për arritjen e OZHM, ato ende nuk janë të mjaftueshme, prandaj puna jonë duhet të vazhdojë. Shumë njerëz në botë – më shumë se 1 bilion – vazhdojnë të rrojnë në varfëri dhe përjetojnë pabarazinë.

OKB ka promovuar nisma të ndryshme, që nga viti 2010, për të përcaktuar prioritetet e zhvillimit që nevojitet të arrihen brenda 15 viteve të ardhshme, nga viti 2016 deri në vitin 2030. Këto prioritete janë ato që ne quajmë Agjenda Post-2015. Për shembull, prioritetet përfshijnë ndaljen e varfërisë së tejskajshme dhe arritjen e mundësive të barabarta për të gjithë.

* Nga ky moment, me fjalën fëmijë do të nënkuptojmë fëmijët dhe adoleshentët.

** Nëse dëshironi të dini më shumë për OZHM, ju ftojme të konsultoni Shtojcën, ku do të gjeni informacione të rëndësishme lidhur me to.

Ç'JANË QËLLIMET PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM?

Në korrik 2014, Shtetet arritën në një marrëveshje dhe hartuan një dokument me një sërë qëllimesh për të vijuar pas OZHM. Qëllimi i këtij dokumenti është të ndihmojë në udhëheqjen e përpjekjeve globale për të garantuar që njerëzit në mbarë botën të jetojnë më mirë, pa dëmtuar planetin. Kur ky dokument dhe qëllimet përkatëse të jenë përfunduar, Shtetet do të punojnë për arritjen e tyre brenda 15 viteve të ardhshme, 2016-2030. Këto qëllime, që vijnë pas përfundimit të OZHM, njihen me emrin Qëllimet për Zhvillim të Qëndrueshëm (Nga ky moment do t'i quajmë QZhQ).

SI U PËRZGJODHËN QZHQ?

OKB kryesoi një Grup Pune të Hapur (GPH), të përbërë nga përfaqësuesit e Shteteve, i cili gjatë vitit të fundit u mbledh 13 herë. I shoqëruar nga një ekip ekspertësh teknikë në fushën e arsimit, shëndetit dhe fusha të tjera, ky grup diskutoi për problemet më urgjente me të cilat njerëzit në mbarë botën përballen dhe të cilat pengojnë përmirësimin e jetës së të gjithëve. Bazuar në këto diskutime, grupi hartoi qëllimet dhe objektivat të cilat fokusohen në një sërë temash të ndryshme. Për shembull, disa nga temat e rrahura qenë ndalja e varfërisë së tejskajshme dhe urisë dhe garantimi i të drejtave të njeriut, paqes dhe barazisë gjinore si edhe ruajtja e mjedisit.

Dokumenti përfundimtar i përgatitur nga GPH propozoi 17 qëllime dhe 169 objektiva, por diskutimi mbi QZhQ për 15 vitet e ardhshme nuk ka përfunduar. Për këtë arsye është e rëndësishme që komuniteti botëror në përgjithësi dhe fëmijët në veçanti të marrin pjesë në këtë proces. Mendimet e tyre duhen dëgjuar dhe inputi i tyre duhet integruar në listën përfundimtare të QZhQ për të cilën do të bihet dakord.


Ky udhëzues do të shpjegojë qëllimet (QZhQ) e propozuara nga GPH dhe objektivat për secilin qëllim. Pasi këto qëllime dhe objektiva të jenë përfunduar dhe të jetë rënë dakord për to, komuniteti ndërkombëtar do të punojë i bashkuar për arritjen e tyre brenda vitit 2030.

2000-2015
OBJEKTIVAT E
ZHVILLIMIT TË
MIJËVJEÇARIT (OZHM)



2015-2030
QËLLIMET PËR
ZHVILLIM TË
QËNDRUESHËM (QZHQ)

POR, Ç'ËSHTË ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM AI?



Zhvillimi i qëndrueshëm është zhvillimi që përmirëson kushtet e jetesës në të tashmen pa vënë në rrezik burimet për brezat e ardhshëm.

Zhvillimi NUK është i qëndrueshëm nëse ne shpenzojmë apo përdorim tani të gjitha burimet që kemi, duke mos lënë asgjë për brezat e ardhshëm. Zhvillimi i qëndrueshëm nënkupton të rritemi së bashku, duke përmirësuar mënyrën e të menduarit të të tjerëve dhe duke respektuar mjedisin.

Për të garantuar zhvillimin e qëndrueshëm, duhet të punojmë së bashku në mënyrë që të sigurohemi që janë duke u bërë ndryshime të rëndësishme për transformimin e shoqërisë sonë në një shoqëri më të drejtë dhe të barabartë. Drejtuesit tanë duhet të angazhohen në realizimin e këtyre ndryshimeve, por edhe ne duhet të bëjmë pjesën tonë. Për shembull, ne mund të japim mendimin tonë mbi çështjet që prekin fëmijët, duke analizuar dhe debatuar mbi botën që ëndërrojmë për veten dhe për brezat e ardhshëm.

HISTORIA E JOANËS

Shoqja ime Joana që mëson me mua kujdeset gjithnjë shumë për gjërat e saj. Ajo e di sa u kushton prindërve të saj që t'ia sigurojnë këto gjëra. Joana i admiron ata. Babai i saj punon në bujqësi dhe nuk përdor pesticide që e dëmtojnë tokën Ai e di se, nëse ne abuzojmë me tokën, ajo thjesht nuk do të na japë më asgjë. Mamaja e saj prodhon disa lloje djathërash shumë të shijshëm dhe i shet me çmim të arsyeshëm. Ata nuk janë milionerë, por fitojnë mjaftueshëm për të jetuar. Kurrë nuk e kam parë Joanën të mendojë për çfarë modeli telefoni të ri të blejë. Në vend që të mendojë për telefonat, ajo mendon për të ardhmen e saj dhe për çfarë do t'i pëlqente të studionte, edhe pse ende është në mëdyshje midis bujqësisë dhe arsimit.

NË Ç'BOTË DËSHIROJMË TË JETOJMË?

Zëri i fëmijëve është i rëndësishëm!

NJË MOMENT ...

Përpara se të vijojmë më tej, ju ftojme të luani duke zbuluar në fjalëkryq fjalët e renditura në etiken e verdhë.



A	M	H	D	R	E	A	T	V	A	R
Q	E	L	A	R	S	S	Y	T	I	M
B	R	E	D	I	S	H	K	A	J	A
C	M	P	O	L	I	T	I	K	A	R
I	A	J	R	L	S	E	T	I	R	R
K	R	E	G	O	R	T	E	S	T	J
U	R	S	A	K	C	E	X	I	D	E
L	J	M	B	Y	B	S	T	R	I	C
T	E	A	I	Q	A	H	U	T	H	I
V	A	R	F	E	R	I	A	R	G	M
U	F	R	L	K	A	P	U	L	J	A
I	G	J	E	U	Z	I	Z	F	I	G
N	Q	E	L	L	I	M	E	T	N	I
A	B	J	E	B	N	I	Q	U	I	H
D	R	E	J	T	A	L	A	R	S	Y





QËLLIMI 1

JO VARFËRISË

Qëllimi kryesor i QZhQ është ndalja e varfërisë brenda vitit 2030.

Është një qëllim mjaft i madh! Si do ta arrijmë?

Shtetet që përbëjnë aleancën botërore për luftën kundër varfërisë duhet të ndërmarrin hapa për arritjen e këtij qëllimi dhe OKB duhet të verifikojë që të gjitha Shtetet janë duke bërë një përpjekje.

Po ç'mund të bëjmë ne për të ndihmuar?

Për shembull, ne mund t'u kërkojmë të rriturve të na japin informacion të qartë dhe të përshtatshëm për moshën.

Ne kemi të gjithë të drejtën dhe duhet të na jepet mundësia t'u kërkojmë Shteteve që të përmbushin angazhimet e tyre për krijimin e një bote më të mirë për të gjithë.

Ne mund të flasim me njëri-tjetrin për këto çështje. Mund të marrim pjesë në proceset e konsultimit në mënyrë që zëri ynë të dëgjohej. Mund t'i nxisim qeveritë të na dëgjojnë. Mund të organizohemi.

Për t'i dhënë fund varfërisë, Shtetet propozuan sa më poshtë:

- Të garantohet që çdo individ në shoqëri të jetë i mbrojtur nga fenomene si papunësia dhe të ketë akses të shërbimet mbështetëse si kujdesi mjekësor. Kjo quhet mbrojtje sociale dhe ka kryesisht qëllimin të mbrojtje dhe mbështetëse personat më të varfër dhe më të cenueshëm.
- Të garantohet alokimi i burimeve për vënien në zbatim të politikave sociale që ndihmojnë personat që kanë më pak të ardhura të përfitojnë, pavarësisht kësaj, akses të barabartë të shërbimet bazë, puna, toka dhe teknologjia dhe të mund të krijojnë kompani për t'u rritur ekonomikisht.

Pse është e rëndësishme kjo për fëmijët?
Çfarë tjetër mund të përfshihet këtu për të garantuar të drejtat e fëmijëve?



QËLLIMI 2

JO URISË



Për t'i dhënë fund urisë, Shtetet propozuan sa më poshtë:

- Të ndalet kequshqyerja duke përmirësuar programet sociale për fëmijët, nënat dhe të moshuarit dhe duke garantuar ushqim të sigurt, të shëndetshëm dhe të mjaftueshëm përgjatë gjithë vitit.
- Të rritet prodhimi bujqësor dhe të ardhurat e fermerëve të vegjël, veçanërisht grave dhe minoriteteve, duke respektuar mjedisin, biodiversitetin e çdo rajoni dhe burimet e tyre.
- Të parandalohen probleme të tilla si thatësira, përmytjet dhe fatkeqësi të tjera.
- Të mbrohet larmia e specieve të farave, të lashtave dhe kafshëve të fermës (shtëpiake dhe të egra) dhe të shpërndahen në mënyrë të drejtë përfitimet që vijnë nga këto burime.

HISTORIA E PAULËS DHE LUIZËS

Paula ishte gjithnjë e shqetësuar për Luizën, vajzën e saj dyvjeçare, e cila ishte më e imët dhe e dobët se moshataret e saj. Ato jetonin në mal, ku bënte ftohtë, kështu që Paula e ushqente Luizën me supë të nxehtë dhe lëng mishi. Kështu deri ditën që Paula pa në TV një mesazh të qeverisë në të cilin një nënë këshillonte të ushqyerit e fëmijës me një pjatë me perime, vezë dhe mish në vend të supës dhe lëngut të mishit. Që nga ai moment, Paula nisi të përmirësonte të ushqyerit dhe shëndetin e foshnjës së saj.



Çfarë tjetër duhet marrë parasysh për të garantuar që çdokush të ketë ushqim të mjaftueshëm dhe të shëndetshëm?



QËLLIMI 3

SHËNDET I MIRË

Sigurimi i një jete të shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë, në çdo moshë

Për të siguruar një shëndet të mirë për të gjithë, Shtetet propozuan sa më poshtë:

- Të reduktohet numri i nënave që vdesin gjatë lindjes.
- Të parandalohet vdekja e të porsalindurve dhe fëmijëve nën moshën 5 vjeç.
- Të ndalen epidemitë e tilla si HIV/AIDS dhe sëmundje të tjera si hepatiti apo sëmundjet e transmetueshme përmes ujit.
- Të edukohen personat lidhur me parandalimin dhe abuzimin me drogën dhe alkoolin si edhe lidhur me problemet e shëndetit mendor.
- Të ofrohet informacion lidhur me planifikimin familjar, edukimin seksual dhe shëndetin riprodhues.
- Të garantohet që gjithkush të gëzojë të drejtën për një shëndet të mirë, e cila përfshin kujdes mjekësor të një cilësie të lartë dhe barna dhe vaksina të arritshme dhe ekonomike.

A e ke dëgjuar ndonjëherë shprehjen "shëndeti mbi të gjitha"?

Prandaj ka edhe një qëllim që lidhet me shëndetin.

Po dhe jam dakord me të sepse askush nuk mund të punojë apo studiojë kur është sëmurë.

Brenda vitit 2030 të gjithë duhet të jenë të mbrojtur nga sëmundjet apo aksidentet.

Le t'u hedhim një sy objektivave për arritjen e këtij qëllimi pasi mund të kenë harruar ndonjë gjë të rëndësishme që ka të bëjë me shëndetin tonë.

Çfarë duhet të merret parasysh për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve?

QËLLIMI 4

ARSIM CILËSOR



Për të siguruar një arsim cilësor për të gjithë, Shtetet propozuan sa më poshtë:

- Të garantohet arsimi për të gjithë, duke filluar nga arsimi bazë.
- Të ofrohen më shumë mundësi formimi teknik dhe profesional për të rinjtë dhe të rriturit në mënyrë që ata të mund të sigurojnë vende pune më të mira.
- Të ndalet pabarazia në ofrimin e mundësive të arsimimit mes burrave dhe grave, fëmijëve me aftësi të kufizuara, dhe viktimave të konflikteve.
- Të përmirësohen strukturat e shkollave për të siguruar një mjedis të sigurt dhe pozitiv për të gjithë.
- Të rritet numri i bursave për kurset e formimit profesional dhe teknik, brenda dhe jashtë vendit.
- Të krijohen mësues më të mirëtrajnuar.
- Të promovohet edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm.

HISTORIA E KARMENIT


Karmeni dhe dy vëllezërit e saj nuk po shkonin në shkollë. Që të tre ndihmonin prindërit në fermë dhe nuk kishin para të mjaftueshme për të frekuentuar shkollën. Kjo ndryshoi kur shteti hapi një shkollë të re e cila u jepte atyre arsim falas. Të gjithë fëmijët e komunitetit të tyre patën mundësi të shkolloheshin. Jo vetëm, por mësuan edhe për farat, teknikat për përmirësimin e ujitjes së të mbjellave dhe aftësi të tjera të dobishme. Me pak fjalë, ishte një shkollë ku gjithkush trajtohej njësoj si të tjerët, pavarësisht nëse ishte djalë apo vajzë, i pasur apo i varfër. Gjithkush kishte të njëjtën të drejtë për t'u shkolluar.

Çfarë tjetër nevojitet për të bërë që të gjithë fëmijët të kenë një arsim të mirë?



QËLLIMI 5


BARAZI GJINORE



Pamelix: Hej, ç'kemi? Gjeje çfarë ka ndodhur!
Oskar33: Ç'kemi Pamela? Ç'ka ndodhur? Më trego!
Pamelix: Më pranuan në universitet.
Oskar33: Hajde lajm! Çfarë do të studiosh?
Pamelix: Inxhinieri mekanike.
Oskar33: Hahahaha! Po, po... Hë se e kam seriozisht...
Pamelix: Edhe unë seriozisht e kam.
Oskar33: E përse ke zgjedhur të bësh diçka kaq mashkullore?
Pamelix: Unë kam që kur kam qenë e vogël që ndihmoj babin me e në oficinë. Nuk më duket diçka vetëm për meshkuj.
Oskar33: Mirë, mirë, qetësohu! Mos u nxeh! E di që babit tim iu prish makina dje?! A na ndihmon dot?
Pamelix: Patjetër, me kënaqësi! Shihemi më vonë në oficinë pra.

Për arritjen e barazisë gjinore, Shtetet propozuan sa më poshtë:

- Të ndalet çdo formë dhune ndaj grave dhe vajzave, përfshirë trafikun seksual dhe forma të tjera të shfrytëzimit.
- Të ndalen të gjitha praktikat dhe zakonet që mund të dëmtojnë shëndetin fizik, mendor dhe seksual të grave dhe vajzave.
- Të njihet dhe vlerësohet puna e grave në shtëpi.
- Të nxiten gratë dhe vajzat që të kenë mundësi të barabarta për t'u dëgjuar si dhe mundësi reale për të marrë pjesë në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe publike.
- Të mbrohen të drejtat e grave për një shëndet të mirë seksual dhe riprodhues.
- Të promovohen politika dhe ligje për garantimin e barazisë gjinore.



Përse është e rëndësishme kjo për ju? Çfarë tjetër duhet bërë për të promovuar barazinë mes burrave dhe grave, djemve dhe vajzave?

QËLLIMI 6

UJË I PASTËR DHE KANALIZIME



Për arritjen e qëllimit 6, Shtetet propozuan sa më poshtë:

- Të garantohet që të gjithë të kenë akses te uji i kontrolluar.
- Të garantohet që të gjithë të kenë akses te kanalizimet (sistemi i ujërave të zeza dhe menaxhimi i mirë i mbetjeve) dhe te edukimi publik mbi shprehitë higjienike të shëndetshme.
- Të monitorohet cilësia e ujit për të reduktuar ndotjen e tij. Të parandalohet hedhja e agjentëve kimikë apo ndotës në ujë.
- Të përmirësohet përdorimi i ujit, duke zhvilluar burime më të mëdha për ripërdorimin e tij.
- Të rritet ndërgjegjësimi i komuniteteve për të garantuar që ato të luajnë një rol aktiv në përmirësimin e menaxhimit të ujit dhe kanalizimeve.

HISTORIA E MATIAS

Matia dhe thujse të gjithë fëmijët e lagjes së tij ishin të sëmurë. Edhe të rriturit kishin probleme me shëndetin. Kur shkuan në qendrën shëndetësore më të afërt, mjekët u thanë që shkaku i problemeve shëndetësore ishte me shumë mundësi uji – të cilin ua sillnin me një cisternë çdo dy ditë – përderisa të gjithë kishin të njëjtat simptoma. Në fakt, uji ishte vërtet i ndotur dhe, përderisa shumë pak prej tyre kishin soba me gaz, ata nuk kishin mundësi ta zienin ujin para se ta pinin apo të gatuanin me të.



Çfarë tjetër mund të bëhet në mënyrë që të gjithë fëmijët të kenë akses te uji i pastër?



QËLLIMI 7

ENERGJI E RINOVUESHME



Për të garantuar që çdokush të ketë akses te energjia, Shtetet propozuan sa më poshtë:

- Të garantohet aksesin në energjinë moderne dhe të sigurt për të gjithë.
- Të promovohet përmirësimi i shprehive të përdorimit të energjisë me qëllim kursimin e saj.
- Të sigurohet për të gjithë aksesin te energjia e pastër si dhe te informacioni dhe studimet kërkimore.

Përse është e rëndësishme energjia për ju?

QËLLIMI 8

PROFESIONE TË MIRA DHE RITJE EKONOMIKE



Ne duhet të sigurohemi që të gjithëve t'u krijohet mundësia për të pasur një profesion të mirë dhe të sigurt, i cili të garantojë që të drejtat e çdokujt të jenë të mbrojtura.

Po për punën, çfarë mendon?

Për garantimin e profesioneve të mira dhe rritjes ekonomike për të gjithë, Shtetet propozuan sa më poshtë:

- Të ofrohen mundësi për punë të sigurta dhe kreative, të cilat stimulojnë zhvillimin e individit.
- Të garantohet respektimi dhe mbrojtja e burimeve natyrore në të gjitha veprimtaritë ekonomike.
- Të promovohen profesionet e mira për të gjithë, burra dhe gra, të rinj dhe persona me aftësi të kufizuara.
- Të reduktohet numri i të rinjve të papunë duke rritur aksesin në kurset e formimit.
- Të parandalohet dhe ndalet puna e detyruar e të miturve, përfshirë rekrutimin e fëmijëve ushtarë.
- Të ndërmerren veprime në nivel botëror për të punësuar më shumë të rinj.



Përse është i rëndësishëm për fëmijët ky qëllim? Çfarë tjetër duhet të përfshihet në mënyrë që të garantohen këto të drejta?

INOVACIONI DHE INFRASTRUKTURA



Për arritjen e qëllimit 9, Shtetet propozuan sa më poshtë:

- T'u sigurohet bizneseve të vogla akses i lehtë tek kredia dhe mbështetja teknike për zhvillimin e tyre.
- Të garantohet që kompanitë të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të mos dëmtojnë mjedisin.
- Të alokohen burime për studime kërkimore në mënyrë që të adresohen nevojat specifike të vendit dhe të përmirësohet teknologjia.
- Të garantohet që të gjithë të kenë akses te interneti dhe teknologjia më e re, veçanërisht ata që jetojnë në vendet më pak të zhvilluara, brenda vitit 2020.

A mendoni se Shtetet dhe bizneset mund të bëjnë më shumë për mjedisin?

QËLLIMI 10

REDUKTIMI I PABARAZIE



Si reduktohet pabarazia?

Shtetet duhet të mobilizohen në mënyrë që të gjithë banorët e tyre të përfshihen dhe të mos diskriminohen.

Ashtu është! Unë inatosem shumë kur ndihem si i harruar ose kur njerëzit nuk na marrin në konsideratë.

Në ç'raste të qëllon ta ndjesh veten ndryshe nga të tjerët? A mendon se duhet të përfshihen edhe objektiva të tjera në këtë drejtim?

Për reduktimin e pabarazisë, Shtetet propozuan sa më poshtë:

- Të ofrohet mbështetje për personat që jetojnë në varfëri për t'u mundësuar atyre aksesin tek mbështetja për një rritje ekonomike të shpejtë dhe të qëndrueshme.
- Të garantohet që ligjet dhe praktikat të mos diskriminojnë asnjë grup shoqëror por, përkundrazi, të dëgjohen nevojat e të gjithëve dhe të merret parasysh inputi i personave të prekur.
- Të garantohet që ligjet dhe programet sociale të mbrojnë personat e paavantazhuar dhe të cenueshëm. Për shembull, kur përcaktohen kuotat e një partie politike, duhet të përfshihen në të edhe të rinjtë, gratë, minoritetet dhe personat me aftësi të kufizuar.
- Të garantohet që personat që lënë një vend për të jetuar në një tjetër të përfitojnë nga ligje të krijuara për mbrojtjen e tyre.





QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME

Për të garantuar që qytetet dhe komunitetet të jenë gjithëpërfshirëse, të sigura, të ripërtërishme dhe të qëndrueshme, Shtetet propozuan sa më poshtë:

Brenda vitit 2030 ne duhet të jetojmë në qytete të sigura e të pastra, me strehim cilësor dhe shërbime bazë.



Sigurisht, krahas parqeve për të luajtur dhe transportit të sigurt për të gjithë.



- Të garantohet për të gjithë aksesin të cilësia, strehimi i sigurt dhe shërbimet bazë.
- Të sigurohet transport i sigurt dhe i organizuar i cili të mos jetë i dëmshëm për mjedisin dhe të jetë i planifikuar posaçërisht për t'u shërbyer fëmijëve, grave dhe personave të cenueshëm.
- Të angazhohen komunitetet në diskutime dhe në proceset e planifikimit për përmirësimin e qyteteve të tyre.
- Të promovohet vlerësimi dhe mbrojtja e mjedisit dhe kulturës.
- Të rritet aftësia ripërtëritëse ndaj katastrofave.
- Të garantohet monitorimi i menaxhimit të mbetjeve dhe i cilësisë së ajrit.
- Të përgatiten komunitetet për të menaxhuar në mënyrën e duhur burimet e tyre dhe për të adresuar në mënyrë të përqendruar ndryshimet klimatike.

Cilët janë faktorët më të rëndësishëm që u mundësojnë fëmijëve të jetojnë në qytete dhe komunitete më të mira?

QËLLIMI 12

KONSUM I PËRGJEGJSHËM



Për arritjen e qëllimit 12, Shtetet propozuan sa më poshtë:

- Të parandalohet shpërdorimi i ushqimit nga individët dhe kompanitë.
- Të garantohet që, brenda vitit 2020, të përmbushen marrëveshjet ndërkombëtare për trajtimin e agjentëve kimikë të dëmshëm, duke u kujdesur për ajrin, ujin dhe tokën.
- Të reduktohet prodhimi i mbetjeve përmes tri R-ve: Reduktimit, Ripërdorimit dhe Riciklimit.
- Të garantohet që praktikat e kompanive të mëdha të jenë të përgjegjshme, të hapura dhe të shëndetshme për mjedisin.
- T'i sigurohet popullsisë informacion dhe edukim i vazhdueshëm dhe t'u ofrohen atyre mjetet e nevojshme për të jetuar në harmoni me natyrën.



A mendoni se duhet të merren në konsideratë edhe veprime të tjera?



QËLLIMI 13

VEPRIME PËR KLIMËN



Për arritjen e qëllimit 13, Shtetet propozuan sa më poshtë:

- Të garantohet që popullsia të jetë e mirëpërgatitur për rreziqet që lidhen me klimën dhe fatkeqësitë natyrore.
- Të përfshihen çështjet e ndryshimeve klimatike në agjendat qeveritare dhe të alokohen burime për të luftuar këto ndryshime.

A është e rëndësishme kjo për fëmijët? Çfarë duhet pasur parasysh?

QËLLIMI 14

JETA NËN UJË



Për të garantuar që jeta nën ujë të jetë e mbrojtur, Shtetet propozuan sa më poshtë:

- Të reduktohet ndotja e ujërave të detit brenda vitit 2025, duke pasur parasysh se shumica e ndotjes së tyre shkaktohet nga veprimtaritë e njeriut në tokë.
- Të miratohen ligje që ndalojnë peshkimin e paligjshëm dhe praktika të tjera të dëmshme peshkimi brenda vitit 2020.
- T'u ofrohet shteteve më të varfra dhe ishujve të vegjël mbështetje financiare për mbrojtjen dhe një menaxhim më të mirë të burimeve detare, me një vështrim tek e ardhmja.



 A është e rëndësishme kjo për fëmijët? Çfarë duhet pasur parasysh?



QËLLIMI 15

JETA NË TOKË



Për mbrojtjen e tokës, Shtetet propozuan sa më poshtë:

- Të mbrohen dhe ruhen ekosistemet (për shembull, shkretëtirat dhe pyjet e shiut) duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara.
- Të reduktohet shpyllëzimi dhe të mbillen më shumë pemë me qëllim ripyllëzimin brenda vitit 2020.
- Të mbrohen speciet në rrezik zhdukjeje dhe të ndërhyhet urgjentisht për parandalimin e zhdukjes së tyre; të ndalet gjuetia e pakontrolluar dhe trafiku i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës. Është e rëndësishme të përfshihen edhe minoritetet.

A është e rëndësishme kjo për fëmijët? Çfarë duhet pasur parasysh?



QËLLIMI 16

PAQJA DHE DREJTËSIA



Për arritjen e qëllimit 16, Shtetet propozuan sa më poshtë:

- Të ndalet dhuna në botë dhe vdekjet e shkaktuara prej saj.
- Të ndalet abuzimi, shfrytëzimi, trafikimi dhe të gjitha format e dhunës dhe torturës ndaj fëmijëve.
- Të garantohet që të gjithë të kenë akses të barabartë të drejtësia në vendin e tyre dhe në nivel ndërkombëtar.
- Të luftohet krimi dhe korrupsioni me çdo formë.
- Të përmirësohen institucionet shtetërore që nxisin besim te populli.
- Të garantohet konsultimi i qeverive me popullsinë gjatë proceseve të vendimmarrjes si edhe marrja e vendimeve duke mbajtur gjithnjë parasysh interesin e fëmijëve dhe të rriturve. Për shembull, fëmijët duhet të konsultohen para nënshkrimit të një ligji që do të ndikojë në jetën e tyre.
- Të garantohet pajisja e të gjithë fëmijëve me një certifikatë identiteti dhe regjistrimi i tyre në lindje.
- Të garantohet për të gjithë aksesin falas te informacioni.
- Të forcohen institucionet në mënyrë që të parandalohet dhuna, terrorizmi dhe krimi.



Çfarë tjetër duhet bërë për të ndalur dhunën? Po për të ndalur dhunën ndaj fëmijëve?



PARTNERITETE PËR QËLLIMET

Për arritjen e këtyre qëllimeve, Shtetet propozuan sa më poshtë:

Tashmë ne i njohim qëllimet dhe objektivat e propozuara.

Le të shohim çfarë do të bëjnë shtetet për t'i arritur këto qëllime dhe objektiva!

- Të ofrohet ndihmë për të garantuar që të gjitha vendet t'i kenë përmbushur këto qëllime brenda vitit 2030. QZhQ duhet të jenë të pranishme në planet kombëtare dhe çdo shtet duhet të përcaktojë cilat janë çështjet më urgjente për të.
- Të garantohet që çdo shtet të alokojë burimet e tij për arritjen e qëllimeve. Veç kësaj, vendet e zhvilluara duhet të angazhohen për të mbështetur arritjen e këtyre qëllimeve edhe nga vendet më pak të zhvilluara.
- Të respektohen vendimet e politikave të vendeve të ndryshme, me kusht që këto të mos jenë kontradiktore. Për shembull, nuk mund të vendosen rregulla për mbrojtjen e burimeve natyrore dhe në të njëjtën kohë të jepet leja për shfrytëzimin e tyre.
- Të punohet me organizata dhe individë të angazhuar prej vitesh në çështje që kanë të bëjnë me QZhQ. Këto organizata dhe individë duhet të përfshihen në punën për arritjen e qëllimeve pasi përvoja dhe mbështetja e tyre janë të nevojshme.
- Të garantohet që, brenda vitit 2020, shtetet të kenë përmirësuar menaxhimin e të dhënave dhe statistikave në mënyrë që të mund të vlerësohet përparimi i tyre drejt përmbushjes së QZhQ.

Tani që i njihni të gjitha qëllimet, lidheni secilin qëllim me ikonën përkatëse:

- QËLLIMI 1 JO VARFËRISË
- QËLLIMI 2 JO URISË
- QËLLIMI 3 SHËNDET I MIRË
- QËLLIMI 4 ARSIM CILËSOR
- QËLLIMI 5 BARAZI GJINORË
- QËLLIMI 6 UJË I PASTËR DHE KANALIZIME
- QËLLIMI 7 ENERGJI E RINOVUESHME
- QËLLIMI 8 PROFESIONE TË MIRA DHE RITJE EKONOMIKE
- QËLLIMI 9 INOVACION DHE INFRASTRUKTURA
- QËLLIMI 10 REDUKTIMI I PABARAZIVE
- QËLLIMI 11 QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME
- QËLLIMI 12 KONSUM I PËRGJEGJSHËM
- QËLLIMI 13 VEPRIME PËR KLIMËN
- QËLLIMI 14 JETA NËN UJË
- QËLLIMI 15 JETA NË TOKË
- QËLLIMI 16 PAQJA DHE DREJTËSIA
- QËLLIMI 17 PARTNERITETE PËR QËLLIMET



FALEMINDERIT PËR PJESËMARRJEN

Përpara se të ndahemi, le të bëjmë një diskutim në grupe:



Cilat qëllime mendoni se janë më të rëndësishme për fëmijët?
Renditini qëllimet sipas prioritetit.

- 1
- 2
- 3
- 4
- 5






A ka ndonjë gjë të cilën ju e konsideroni shumë të rëndësishme për garantimin e të drejtave të fëmijëve por nuk e shihni të pasqyruar në dokument?



SHTOJCË Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (2000 – 2015) dhe nënobjektivat përkatës



Qëllimi 1: Eliminimi i varfërisë ekstreme dhe i urisë

Midis viteve 1990 dhe 2015, të përgjysmohet përqindja e personave të uritur.

Midis viteve 1990 dhe 2015, të përgjysmohet përqindja e personave të ardhurat e të cilëve janë më pak se një dollar në ditë.

Të sigurohet punë produktive dhe dinjitoze për të gjithë, përfshirë gratë dhe të rinjtë.

Qëllimi 2: Arritja e arsimitit parësor universal

Të garantohet që, brenda vitit 2015, fëmijët e të dyja gjinive të jenë të aftë të kryejnë ciklin e plotë të shkollimit fillor.

Qëllimi 3: Nxitja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i gruas

Të eliminohet pabarazia gjinore në arsimin fillor dhe atë të mesëm të ulët mundësisht brenda vitit 2005 dhe në të gjitha nivelet e arsimit brenda vitit 2015.

Qëllimi 4: Reduktimi i vdekshmërisë foshnjore

Midis viteve 1990 dhe 2015, të reduktohet me 2/3 vdekshmëria e fëmijëve nën 5 vjeç.

Qëllimi 5: Përmirësimi i shëndetit të nënës

Midis viteve 1990 dhe 2015, të reduktohet me 3/4 vdekshmëria e nënave.

Të arrihet akses universal në shëndetin riprodhues.

Qëllimi 6: Luftimi i sëmundjeve HIV/AIDS, malaries etj;

Të ndalet dhe të fillojë të sprapsset përhapja e HIV/AIDS brenda vitit 2015.

Të arrihet, brenda vitit 2010, akses universal tek trajtimi për sëmundjen e HIV/AIDS për të gjithë ata të cilëve u nevojitet ky trajtim.

Të ndalet dhe të fillojë të sprapsset, brenda vitit 2015, incidenca e malaries dhe sëmundjeve të tjera më të përhapura.

Qëllimi 7: Sigurimi i qëndrueshmërisë së mjedisit

Të integrohen parimet e zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet shtetërore dhe të frenohet shpërdorimi i burimeve mjedisore.

Të reduktohet dhe ngadalësohet në mënyrë të konsiderueshme humbja e biodiversitetit brenda vitit 2010.

Të përgjysmohet, brenda vitit 2015, përqindja e personave që nuk kanë akses të qëndrueshëm tek uji i sigurt dhe kanalizimet bazë.

Të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme jeta e të paktën 100 milionë banorëve të lagjeve të barakave brenda vitit 2020.

Qëllimi 8: Zhvillimi i një partneriteti global për zhvillimin

Të vazhdojë të zhvillohet një sistem tregtar dhe financiar, i parashikueshëm dhe jodiskriminues, bazuar në rregulla.


Të përmbushen nevojat e veçanta të vendeve më pak të zhvilluara.

Të përmbushen nevojat e veçanta të vendeve në zhvillim pa dalje në det dhe vendeve të vogla ishullore (përmes Programit të Veprimit për një Zhvillim të Qëndrueshëm të Shteteve të Vegjël Ishullorë dhe rezultateve të seancës së veçantë të njëzetedytë të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së).

Të trajtohen në mënyrë të gjithanshme problemet e borxheve të vendeve në zhvillim përmes masave kombëtare dhe ndërkombëtare për t'i bërë këto borxhe të qëndrueshme në planin afatgjatë.

Në bashkëpunim me kompanitë farmaceutike, të sigurohet akses tek barnat më thelbësore me çmime të përballueshme në vendet në zhvillim.

Në bashkëpunim me sektorin privat, të ofrohet akses tek avantazhet e teknologjive të reja, veçanërisht atyre të informacionit dhe komunikimit.





Lëvizja Botërore për Fëmijët e Amerikës Latine dhe Karaibeve

Lëvizja e Amerikës Latine dhe Karaibeve për Fëmijët (MMI-LAC) është një aleancë strategjike e organizatave kryesuese dhe rrjeteve të rajonit të cilat punojnë për promovimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe adoleshentëve. Kjo aleancë përfshin YMCA, Zyrën Ndërkombëtare të SOS Fshatrat e Fëmijëve, Aleancën e Fondit për Fëmijët, Linjën Telefonike për Fëmijët, Defence for Children International (DCI), ECPAT, Institutin Ndëramerikan për Fëmijët (IIN) të OAS, Plan International, Rrjetin e Amerikës Latine dhe Karaibeve për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Adoleshentëve (REDLAMYC) ANDI International, Save the Children, UNICEF dhe World Vision International, krahas Qendrës Ndërkombëtare për Fëmijët e Humbur dhe të Shfrytëzuar (ICMEC), Foundation Marist Solidarity International (FMSI) dhe Viva Network si vëzhgues.

MMI-LAC forcon promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe adoleshentëve në Amerikën Latine dhe Karaibe përmes: a) mobilizimit për promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe adoleshentëve; b) artikulimit të përpjekjeve për një advokim më efektiv të të drejtave të fëmijëve; c) promovimit të shkëmbimeve dhe sistematizimit të përvojave të suksesshme dhe d) mbështetjes së koordinimit efikas mes shoqërisë civile, fëmijëve dhe adoleshentëve, qeverive dhe organizatave ndërkombëtare dhe agjencive multilaterale.

